



Pranuar - Prinjeno Më/Dena 28.02.2019			
Nr. i organit Org. broj	Numri/Broj	Shtetçi Prilog	Vlera Wednoe
02-035/02		200	

VENDIM PËR SHPALLJEN E THIRRJES PUBLIKE PËR MBËSHTETJE FINANCIARE PUBLIKE PËR PROJEKTE/PROGRAME TË ORGANIZATAVE JO-QEVERITARE



KOMUNA E VITISË

Në bazë të nenit 13, paragrafi 1 i Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 lidhur me nenin 51 paragrafi 1 i statutit të komunës së Vitisë Nr. 01-013/491 të datës 21.04.2011, kryetari i komunës në bazë të kompetencave ligjore bie këtë:

VENDIM

Për shpalljen e thirrjes publike për mbështetje financiare publike për projekte/programme të organizatave jo-qeveritare në fushën e Kulturës, Rinisë dhe Sportit

I

1. Për implementimin e thirrjes publike do të zbatohen dispozitat e rregullores mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve.
2. Mbështetja financiare publike për projektet/programet OJQ-ve do të ofrohet nga Buxheti i Komunës së Vitisë, kodi ekonomik Subvencione, në kuadër të programit/nënprogramit të Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport,

II

1. Mjetet e përmendura në nenin do të shpërndahen në bazë thirrjes publike për financimin e projekteve të OJQ-ve, sipas dokumentacionit për zbatimin e thirrjes, e cila është pjesë përbërëse e këtij vendimi.

III

1. Dokumentacioni për zbatimin e thirrjes sipas pikës II. të këtij vendimi përfshinë:
 1. Teksti i thirrjes publike
 2. Udhëzimet për aplikantët
 3. Formularët e aplikimit
 4. Forma për vlerësimin e cilësisë së projekteve
 5. Format për raportimin e zbatimit të projektit
2. Formularët e aplikimit referuar në paragrafin 1 të këtij neni janë:
 1. Forma e përshkrimit të programit apo projektit
 2. Forma e buxhetit të programit apo projektit
 3. Forma e deklaramit të mungesës së fondeve të dyfishta
 4. Deklarata e partneritetit (nëse është e aplikueshme)
 5. Forma e deklaratës së programit apo projekteve të OJQ-ve të financuara nga burimet publike
 6. Deklarata për aktivitetet e kontraktorit e përmendur në përshkrimin e aktiviteteve të projektit që janë të njohura me programin ose [projektin dhe pjesëmarrjen e tyre në zbatimin (nëse aplikohet)

3. Formularët për zbatimin dhe raportimin e projekteve të referuara në paragrafin 1 të këtij neni janë:
 1. Forma e kontratës për financimin e programit apo projektit
 2. Formulari për përgatitjen e raportit narrativ për projektin apo programin
 3. Formulari për përgatitjen e raportit financiar të programit apo projektit

IV.

Thirrja publike dhe dokumentacioni për zbatimin e thirrjes do të publikohen në mënyrë të plotë në faqen e internetit të ofruesit të burimeve financiare në ueb faqe e komunës së Vitisë.

V.

1. Në përputhje me Rregulloren për kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik për OJQ-të dhe udhëzuesit për aplikantët, ofruesi i mbështetjes financiare publike do të krijojë një Komision Vlerësues për hapjen dhe regjistrimin e aplikacioneve si dhe verifikimin e kushteve të përcaktuara të thirrjes publike.
2. Komisioni vlerësues do të bëjë vlerësimin e përmbajtjes së aplikacioneve të projekteve të pranura që kanë përmbushur me sukses kushtet formale për të qenë pjesë e konkurrimit sipas paragrafit 1 të këtij neni.
3. Anëtarët e Komisionit Vlerësues do të punojë në përputhje me procedurën e përcaktuar në Udhëzimet për aplikuesit dhe rregullat e parapara me rregulloren për financimin publik të OJQ-ve.

VI.

1. Pasi të merret vendimi mbi aplikuesit e suksesshëm, projektet e të cilëve i plotësojnë kushtet për financim, udhëheqësi i institucionit merr vendim për ndarjen e mjeteve për financimin e projekteve/programeve të OJQ-ve.
2. Ofruesi i mbështetjes financiare do të njoftoj përfituesit për kohën e nënshkrimit të kontratave.
3. Përgjegjës për zbatimin e këtij vendimi është Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport

VII.

Ky vendim hyn në fuqi pas nënshkrimit

Viti, 28 shkurt 2019

Kryetari i Komunës:
z. Sokol HALITI

